



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 14 Prill 2021

Nr: 18

**PROJEKTVENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E UDHËZUESVE PËR MËNYRËN E RAPORTIMIT FINANCIAR NGA PARTITË POLITIKE, KANDIDATËT E LISTAVE SHUMËMËRORE DHE KANDIDATËT E PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË**

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “gj”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumëemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, si vijon:
  - a) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
  - b) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e listave shumëemërore, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
  - c) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

<b>Iirjana NANO</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Arens ÇELA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Dritan ÇAKA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Helga VUKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Muharrem ÇAKAJ</b>	<b>Anëtar</b>

